



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Qershor 2022

Nr: 197

URDHËR

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E PROJEKTAKTEVE ME
KARAKTER NORMATIV PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN
E VOTUESVE NGA JASHTË VENDIT, PËR PROCEDURAT E VOTIMIT, PËR
ADMINISTRIMIN DHE NUMËRIMIN E VOTAVE NGA JASHTË VENDIT DHE
PËRFSHIRJEN E TYRE NË REZULTATIN E PËRGJITHSHËM TË ZGJEDHJEVE PËR
KUVENDIN NË KUADËR TË ZHVILLIMIT PËR HERË TË PARË TË VOTIMIT NGA
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të neneve 19, pika 2, 24, 25 dhe 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve me karakter normativ për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të detajuara që mundësojnë votimit nga jashtë vendit me përbërje si më poshtë vijon:
 - a) Madalena KOJA, Drejtor, Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor;
 - b) Erion META, Drejtor, Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore;
 - c) Jona JOSIFI, Shef Sektori, Sektori për Votimin e Emigrantëve;
 - ç) Ina HORANLLIU, Specialist, Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor;
 - d) Megi ALIU, Specialist, Sektori për Votimin e Emigrantëve.
2. Në këtë grup pune, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.



Data: 15 Qershor 2022

Nr: 197 Prot.

Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve me karakter normativ për përcaktimin e rregullave për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatit e përgjithshëm të zgjedhjeve për kuvendin në kuadër të zhvillimit për herë të parë të votimit nga jashtë vendit.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të përfshijë në punimet e grupit të punës nga një përfaqësues të organizatave të diasporës të angazhuara në veprimtari që synojnë mundësimin e votimit nga jashtë vendit.
4. Grupi i punës ka këto detyra:
 - a) Të hartojë projektaktet për përcaktimin e rregullave për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin si dhe çdo projektakt tjetër që e vlerëson të nevojshëm në kuadër të zhvillimit për herë të parë të votimit nga jashtë vendit. Gjatë hartimit të projektakteve grupi i punës të vlerësojë mundësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përdorimin në votimin nga jashtë vendit të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar
 - b) Të koordinojë procesin e konsultimit publik të këtyre projektakteve si dhe të përgatisë materiale, raporte apo çdo dokumentacion tjetër në funksion të këtij qëllimi.
5. Grupi i punës t'i raportojë periodikisht Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ecurinë e punës.
4. Ngarkohet grupi i punës për hartimin e të gjithë projektakteve objekt i këtij urdhri brenda datës 30 Shtator 2023.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data 15 Qershor 2022
Nr. 192 Prot.

Per ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve me karakter normativ për përcaktimin e rregullave për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për kuvendin në kuadër të zhvillimit për herë të parë të votimit nga jashtë vendit.